

RAPORTO DHUNËN DHE DUKURITË NEGATIVE NË NGJARJET SPORTIVE

Kontakttoni Këshillin për Sport:

Tel: +383 44 666 913 (edhe në Viber)

Web: <https://mkrs-ks.org/?page=1,176>

Email: Keshillipersport@rks-gov.net

STOP VIOLENCE IN SPORT



Mos i urrej njerëzit e tjerë, mos i fyej, mos i sulmo; mos bëj thirrje për rezistencë; mos iu bashko turmës që ushtron dhunë; mos merr pjesë në rrahje; mos e lëndo apo vrit tjetrin; mos kryej zjarrvënie; mos kryej veprime që mund të shkaktojnë rrezik të përgjithshëm; mos i jepni ndihmë personit që ka kryer veprë penale; jepi ndihmë personit që është në rrezik; mos mbaj armë (*çfarëdo*) në mënyrë të pa-autorizuar; mos e pengo dhe mos e sulmo personin zyrtar në kryerjen e detyrës së tij zyrtare; mos i kurdis ndeshjet sportive; denonco secilin person që kryen këto vepra penale.



Co-Funded by the Erasmus+ Programme of the European Union



KËSHILLI PËR SPORT

Të gjithë bashkë për veprimtari sportive korrekte dhe Fair-Play

Thuaj JO dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive

Duaje sportin me shpirt e me zemër, në mënyrë të ndershme dhe të sinqertë, sepse kështu e doni atdheun dhe popullin tuaj.

Nëse jeni të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale, ju do ta dëmtoni sportin, atdheun tuaj, popullin tuaj dhe për këtë do të ballafaqoheni me dënimet si në vijim:

- ❖ **Pjesëmarrja në turmë prej më shumë se tetë veta** që kryen veprë penale të huliganizmit apo veprime të kundërligjshme, dhe me atë rast shkaktohet dëmi material apo lëndimi i ndonjë personi dënohet **me burgim deri në 5 vite**, ndërsa **organizatori** i turmës dënohet **me burgim deri në 10 vite**, i cili dënim, në rastet kur vepra penale përsëritet **mund të ashpërsohet edhe deri në 15 vite burgim**.
- ❖ **Thirrja në rezistencë** dhe mosbindje ndaj urdhërave, masave apo vendimeve të ligjshme të organeve kompetente **dënohet deri në 5 vite burgim**.
- ❖ Në rastet kur kryhet **vrasja** dënimi me burg mund të jetë deri në **25 vite**, ndërsa në rastet kur kryhet **vrasja e rëndë** dënimi mund të jetë **jo më pak se 10 vite burgim ose me burgim të përjetshëm**.

- ❖ Vetëm për veprën penale, **pjesëmarrje në rrahje**, dënimi mund të jetë **deri në 3 vite burgim**.
- ❖ Për veprën penale të **zjarrvënies**, ku si pasojë paraqitet vdekja e personit, dënimi është **jo më pak se 10 vite burgim ose me burgim të përjetshëm**.
- ❖ Kushdo që kryen veprën penale – **shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm**, mund të dënohet me **burgim deri në 12 vite**.
- ❖ Për mosdhënie të ndihmës personit që **gjendet në rrezik për jetë** dënimi mund të jetë **deri në 3 vite burgim**, ndërsa nëse vdes personi që është në rrezik dënimi mund të jetë **deri në 8 vite burgim**.
- ❖ Nëse mbahen, kontrollohen apo posedohen armët në mënyrë të **pa-autorizuar**, dënimi mund të jetë **me gjobë deri në 7,500.⁰⁰ euro dhe me burgim deri në 5 vite**, ndërsa nëse janë më shumë se 4 armë apo më shumë se 400 fishekë, dënimi **me burgim mund të jetë deri në 10 vite**.

- ❖ Nëse **pengoni personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare** – dënimi është **me burgim deri në 5 vite**, ndërsa nëse e sulmoni personin zyrtar **gjatë kryerjes së detyrës zyrtare** – dënimi mund të jetë **deri në 12 vite burgim**.
- ❖ **Kurdisja e ndeshjeve sportive** si veprë penale mund të dënohet **me gjobë, dhe me burgim deri në 10 vite**.
- ❖ Kushdo që i jep **ndihmë kryesit të veprës penale**, pasi që ai e ka kryer veprën penale, mund të dënohet **me burgim deri në 10 vite**.

